



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2010, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve lidhur me situatën e aktuale në burgje

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Edmond Rrushi, Artemis Dralo, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Alban Zeneli, Anduel Xhindi Luan Harusha, Arben Elezi, ,Elena Xhina, Ylli Shehu dhe Spartak Braho.

Mungojnë:

Xhemal Qefalia, Myslym Murrizi, Paulin Sterkaj dhe Lefter Maliqi.

Të ftuar:

Agim Ismaili - Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve

Blerta Doçi- Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve Shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Bardhyl Kaçori - Drejtor i Policisë së Burgjeve

Edis Ibrahim - Këshilltari i Ministrit të Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Po fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve lidhur me situatën aktuale në burgje.

Më parë, dua t'ju bëj me dije për median edhe për të gjithë që janë duke na ndjekur, që Komisionin i Sigurisë ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, sikundër me të gjitha institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së këtij komisioni parlamentar. Ne kemi qenë në institucionin ku ushtron përgjegjësitë e saj Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe rast pas rasti kemi marrë kontakte edhe me drejtuesit e mëparshëm, për të kuptuar qoftë situatën në burgje, qoftë nevojat që ka i gjithë personeli që administrojnë sot burgjet. Në fakt, besoj se është meritë e këtij komisioni që problemi më i parë që na u adresua nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve lidhur me uniformën e munguar prej vitesh të punonjësve të policisë së burgjeve u adresua nga ky komision, në rastin e buxhetit të vitit 2018, si dhe një problem, uroj të jetë zgjidhur, pasi në atë kohë u dha pagesa për uniformën e Policisë së Burgjeve.

Sidoqoftë, kjo është një nga problematikat dhe një nga shembujt e punës së këtij komisioni, ndërkohë që nuk është vetëm kjo çështja që na intereson, por janë disa çështje që lidhen me burgjet, të cilat natyrisht do të dalin edhe gjatë raportimit tuaj, zoti drejtor, por edhe nëpërmjet pyetjeve që do t'ju adresohen nga kolegët.

Ne kemi pasur rast të shohim vetëm një nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve, burgun e Fierit, dhe pas këtij rasti i kemi përgatitur një kërkesë me shkrim Ministrisë së Drejtësisë, për të kuptuar se si është konkretisht situata nëpër burgje, sa është numri total i të dënuarve i shpërndarë në mënyrë nominale në çdo burg, për të kuptuar edhe se ku kishte mbipopullim të burgjeve. Në të njëjtën kohë jemi interesuar edhe për punonjësit e administratës në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, qoftë për stafin që i takon Policisë së Burgjeve, qoftë edhe për stafin tjetër që është civil, për numrin e punonjësve që janë punonjës socialë dhe që duhet të merren me burgjet.

Po kështu, kemi marrë një informacion edhe për pagesën e punonjësve të Policisë së Burgjeve, nëse u paguhet vjetërsia në punë, si dhe për gjendjen e automjeteve që ka në dispozicion Policia e Burgjeve. Pra, duke u nisur nga problemet që konstatuan në burgun e Fierit kemi marrë një informacion që i takon datës 3 qershor 2019, të cilin të gjithë kolegët e kanë përpara.

Ne jemi në një periudhë tjetër kohore, ku pa dyshim edhe për faktin që drejtuesit e përgjithshëm të burgjeve kanë ndryshuar, besoj se ia vlente ta bënim këtë dëgjese me ju sot, për të kuptuar edhe situatën në lidhje me një ndryshim tjetër ligjor që ne kemi miratuar në këtë komision, e kam fjalën për ndryshimin që iu bë ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, për vendosjen e regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë. Besoj se kjo është pjesa tjetër për të cilën do të kishim nevojë për informacion.

Sot të ftuar në komision kemi drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, zotin Agim Ismaili.

Në emër të kolegëve ju uroj mirëseardhjen dhe suksese në detyrë! Më parë kemi pasur rastin të komunikojmë me ju në pozicionin e drejtuesit të AKU-t.

Zoti Bardhyl Kaçori, drejtor i Policisë së Burgjeve, zoti Edis Ibrahim, këshilltar i ministrit të Drejtësisë dhe zonjën Blerta Doçi, përgjegjëse Sektori e Çështjeve Shoqërore.

Faleminderit të gjithëve!

Fjala është për ju zoti drejtor.

Shpresoj të na bëni një përmbledhje të të gjithë situatës për ato pika që ju i keni parë si të rëndësishme për të informuar komisionin tonë parlamentar. Ne ju premtojmë, siç e kemi bërë gjithmonë, jemi në mbështetje të kërkesave të institucionit dhe mendoj se dallimi partiak nuk ka luajtur ndonjë rol të veçantë.

Agim Ismaili – Zonja kryetare, ju falënderoj!

Të nderuar deputetë,

Ndihemi i nderuar të raportoj para Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Dua t'ju falënderoj për gjithë mbështetjen që kemi marrë nga komisioni juaj, pasi siç edhe ju thatë, vëmendja e komisionit ndaj çështjeve të burgjeve, zbatimi i ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, si dhe çështja e sigurisë kanë qenë maksimale.

Për t'ju dhënë një përgjigje të drejtpërdrejtë sa i takon çështjes së uniformës që ju parashtruat, është e vërtetë që ka qenë një problem serioz, por ndërkohë po ju them edhe një ndryshim shumë të fortë në këtë drejtim. Në terma statistikorë fondet për çështjen e uniformave dhe të paraqitjes dinjitoze së Policisë së Burgjeve nga viti 2006 deri në vitin 2018 kanë qenë në shumën 58 milionë lekë, ndërsa vetëm për vitin 2018 është 3-fishi, po ashtu 2-fishi i kësaj shifre 10-vjeçare është edhe për vitin 2019. Pra, ka një ndryshim radikal dhe një vëmendje të shtuar dhe serioze për dinjitetin e Policisë së Burgjeve dhe të punonjësve të sistemit penitenciar.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përmbushje të misionit të saj, për të garantuar sigurinë dhe të drejtat e trajtimit të të dënuarve ka pasur si fokus këto drejtime kryesore, si rritjen e sigurisë në burgje dhe zbatimin e akteve ligjore përmes kontrolleve, përmirësimit të procedurave dhe të akteve nënligjore, bashkëveprimi ndërinstitucional, eliminimi të diskriminimit pozitiv ndaj të ashtuquajturve “të fortë” nëpër burgje, që është një pikë shumë e veçantë e punës dhe e veprimtarisë sonë, si dhe investimeve në teknologji dhe pajisje.

Një vëmendje e shtuar i është kushtuar respektimit të të drejtave të njeriut. Kemi zgjedhur fjalën “vëmendje e shtuar”, për shkak se standardi i respektimit të të drejtave të njeriut ka ardhur duke u rritur, por edhe në këtë drejtim kemi pasur kujdes për ta përmirësuar më tej. Rritja e masave për përmirësimin e kujdesit shëndetësor në burgje, kjo përmes bashkëpunimit me institucionet e shëndetit publik, i cili ka ardhur duke u shtuar, pra nuk është thjesht retorikë, por një realitet që ndodh çdo ditë; rekrutimi i stafit shëndetësor përmes përmirësimit të pagave dhe kontrollit mjekësor të përgjithshëm *chek up-it*. Kjo është hera e parë që ndodh, për të bërë një skanim të gjendjes shëndetësore të të burgosurve, e cila është një iniciativë që është marrë këtë vit, ndërkohë që puna vazhdon dhe është në proces.

Realizimi i investimeve për përmirësimin e infrastrukturës të ambienteve dhe të godinave, të cilat janë bërë në bazë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe të gjetjeve dhe konstatimeve tona, por edhe programi i qeverisë në fund të fundit ka një progres të dukshëm në këtë aspekt. Sivjet janë bërë godinat e reja, të cilat janë sipas standardeve, siç janë godinat te Jordan Misja, investimet te Spitali i Burgjeve, i cili realisht është kthyer në një qendër spitalore të mirëfilltë, investimet në Sarandë, Korçë, Lezhë dhe në pika të tjera.

Përmirësimi i procedurave të rekrutimit të trajtimit të stafit.

Kjo është një pikë shumë e fortë jona gjatë kësaj periudhe, pasi kemi bërë rekrutimin e radhës në Policinë e Burgjeve dhe nuk kemi as edhe një kontestim të vetëm, pra qoftë edhe një person i vetëm të ketë kontestuar rezultatin apo pozicionimin e tij në listë, gjë që është bërë e mundur në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, një proces shumë transparent dhe si i tillë do të vazhdojë edhe për punonjësit e rolit të mesëm dhe i tillë ka qenë edhe për drejtuesit e institucioneve.

Bashkëpunimi ndërinstitucional me partnerët ndërkombëtarë për forcimin e sigurisë publike, shkëmbimin e informacionit dhe realizimin e programeve rehabilituese, është një komponent tjetër i rëndësishëm i punës sonë. Gjithashtu, marrja e masave përgatitore për zbatimin

e regjimit të posaçëm në seksionet e sigurisë së lartë në zbatim të ligjit nr. 108/2018 apo siç njihet ndryshe 41 bis. Kemi bërë të gjitha rregulloret, studim të plotë të të dhënave për të gjithë burgosurit që janë dënuar ose janë në procedurë gjyqimi për vepra penale të parashikuara në këtë nen, si dhe janë kryer investime dhe jemi plotësisht të gatshëm për ta implementuar sipas procedurës, pasi propozimi i arsyetuar i prokurorit paraqitet te ministri dhe më pas kryhet cikli.

Situata e përgjithshme në sistemin e burgjeve ka një përmirësim të ndjeshëm, duke përfshirë të gjitha aspektet e menaxhimit që lidhen me sigurinë, trajtimin e personave me liri të kufizuar, si dhe forcimin e kapaciteteve të stafit. Sistemi i burgjeve në vend e ka tejkaluar problemin e mbipopullimit, ku për herë të parë burgjet janë të nënpopulluara, pra ka vende bosh. Gjithashtu, janë tejkaluar problemet e dhunës dhe të keqtrajtimit të të burgosurve, si dhe ka një përmirësim të ndjeshëm në aspektin e trajtimit të të burgosurve.

Për periudhën janar-shtator 2019 në sistemin e burgjeve janë trajtuar mesatarisht 5490 të burgosur, prej të cilëve 3001 të dënuar, 2158 të paraburgosur dhe 260 prej tyre me masë mjekësore për mjekim të detyruar. Mbipopullimi është një fazë e tejkaluar në sistemin tonë të burgjeve dhe standardet për trajtimin njerëzor dhe human të tyre janë lehtësisht të konfirmuara, duke u nisur nga fakti që në çdo rast ekstradimi autoritetet e huaja konfirmojmë dhe verifikojnë nëse janë kushtet për një trajtim njerëzor, sipas standardeve të tyre, dhe në asnjë rast nuk ka ndodhur të refuzohet ekstradimi për këto shkaqe. Pra, janë konfirmuar standardet, cilësia e shërbimit dhe trajtimi njerëzor i këtyre të burgosurve.

Një punë shumë e veçantë, të cilën e përmenda edhe më sipër, është bërë për përgatitjen e regjimit të posaçëm, sipas ligjit nr. 108/2018, i ashtuquajtur 41 bis. Duhet t'ju them që nevoja për hartimin dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji erdhi si nevojë për të ndërprerë ndikimin me botën jashtë burgut të organizatave kriminale dhe të personave me rrezikshmëri të lartë, të cilët edhe pse ishin në regjim burgu arrinin t'ia dilnin. Në fakt, është e vërtetë që kjo ka ndodhur, por tashmë realiteti ka ndryshuar. Sipas ligjit aktual, po jua them këtë meqë e pranishme është edhe media, para se ky ligj të hynte në fuqi ky ligj ka qenë edhe një normë tjetër për masë shtrënguese ndaj të burgosurve të rrezikshëm, të cilët shkelnin rregullat e burgut dhe arrinin të krijonin edhe hierarki në burg, për shkak të fuqisë së tyre kriminale dhe me bazë ekonomike. Ky është regjimi i mbikëqyrjes së posaçme, sipas nenit 55 të ligjit, i cili ka hyrë në fuqi që në vitin 1998, sipas të cilit drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mund të urdhërojë izolimin dhe mbikëqyrjen e posaçme për një periudhë 3-mujore për secilin të burgosur që i kryen këto shkelje.

Në fakt, kjo normë nuk është zbatuar asnjëherë që nga viti 1998 deri në vitin 2019. Asnjë i burgosur nuk e ka kaluar këtë kalvar, ndërsa gjatë vitit 2019, pikërisht për të shkelmuar favorizimin e trajtimit preferencial të të burgosurve VIP-a, këtë mekanizëm e kemi zbatuar zëm me shumë sukses për 32 raste. Pra, 32 të burgosur të ndryshëm që i kanë shkelur rëndë rregullat e burgut e kanë marrë këtë masë dhe për të gjitha këto raste është njoftuar prokurori dhe gjykata, si dhe me vendim gjykate është konfirmuar si i drejtë vendimi i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Kjo masë ka dhënë efikasitet, sepse në një farë mënyre përmban drejtësi dhe nuk mund të ketë të privilegjuar dhe të paprekshëm në burg, është diçka absurde që kjo gjë të mendohet.

Nëpër burgje ka qetësi, të burgosurit po përfshihen gjithnjë e më shumë nëpër programe rehabilitimi dhe si rezultat i kësaj ka më pak incidente. Dhuna e stafit ndaj të burgosurve është diçka e harruar, por edhe dhuna ndërmjet të burgosurve dhe raste të natyrës në komunitet, i cili jeton 24 orë në 24, natyrisht do të ketë probleme, por këto probleme vijnë duke u minimizuar dhe në përmirësim të dukshëm.

Sa i takon 41 bisit, siç e përmenda edhe më sipër, pikë së pari, si Drejtori e Përgjithshme të Burgjeve kemi të skanuar listën e personave, të cilët potencialisht mund t'i nënshtrohen atij regjimi, jo të futen në atë regjim, kjo për efekt të ligjit. Përveç kësaj kemi bërë një rregullore dhe një program të veçantë monitorimi në lidhje me ta për çfarëdolloj të dhëne që ne përfitojmë, e cila mund të jetë si indicie e vyer për prokurorinë, për të ekzaminuar nëse duhet apo jo të kalojë ky apo ai person në 41 bis. Këto të dhëna i kemi nxjerrë dhe ia kemi vënë në dispozicion prokurorit, i cili detyrimisht i monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe deri tani kemi një bashkëpunim shumë të mirë. Duhet t'ju them se ligji nr. 108/2018 ka katër kushte për të gjithë ata persona që duhet të kalojnë atë, si dhe përmenden fjalën “komunikim, koordinim, ndërveprim me organizatat kriminale”. Kjo në kushtet e burgut kryhet më shumë nëpërmjet celularit ose mënyrave të ndryshme të komunikimit. Këtu ka një problem, të cilin e kemi identifikuar dhe adresuar sa u takon hetimeve penale që lidhen me veprën penale 324/a, që parashikon kriminalizimin kur të burgosurit kapen me sende të ndaluara, ende kjo gjë nuk ka arritur efektet e dëshiruara, për shkak se hetimet cungohen vetëm me identifikimin e faktit ka pasur apo jo celular, por për të hetuar më tej se me kë ka komunikuar dhe se çfarë qëllimi kanë pasur këto telefonata, pse jo për të zbuluar edhe vepra të tjera penale si krim apo shantazh, sepse, siç dihet, në të gjithë botën, por edhe në Shqipëri ka pasur raste që nga burgu janë porositur edhe vrasje në të kaluarën.

Këto hetime nuk kanë qenë të tilla nga organi i prokurori, prandaj këtë çështje ia kemi adresuar prokurorit të Përgjithshëm dhe besoj se së shpejti do të ketë ndonjë ndryshim, pasi për ne një gjë e tillë është problem shumë serioz. Po ashtu, sipas nenit 324/a, paragrafi 2, parashikohet dënim me 5 deri në 15 vjet edhe për bashkëpunëtorët e të burgosurve, të cilët janë nga radhët tona, që me veprime apo mosveprime të kundërligjshme i lejojnë, pasi vetë të burgosurit nuk kanë se si t'i marrin. Në fakt, për dënimin e dikujt nga radhët e efektivit tonë nuk ka rekorde në lidhje me këto çështje që nga viti 2016 kur ligji ka hyrë në fuqi.

Këtë problem e kemi adresuar në rrugë institucionale dhe mendoj se ky fakt do të adresohet në prokuroritë përkatëse, pasi këto ekzaminime mund të jenë një burim shumë i mirë për prokurorinë speciale, aktualisht Prokurorinë e Krimeve të Rënda, e cila kryen funksionet për regjimin 41 bis dhe mbi këto të dhëna të nxirren indicie se kush ndërvepron me qëllim që ta kalojnë në 41 bis. Kemi respektuar të drejtat e të burgosurve dhe trajtimin njerëzor të tyre, duke e parë këtë në disa aspekte, ku përveç rritjes së kujdesit shëndetësor dhe të kujdesit social kemi përmirësuar edhe rregulloren, akte të shkruara këto, sjelljen, përveç këtyre edhe komunikimin në lidhje me ta. Për shembull, për çdo lloj ankese ata marrin një vendim të arsyetuar jo thjesht një përgjigje të thatë, duke u asistuar në mënyrë shembullore. Këtë nuk jua them sa për të kaluar radhën, por realisht ka një përmirësim të ndjeshëm në komunikimin me ta, qoftë nëpërmjet shkresave dhe komunikimeve të ndryshme, por gjithmonë duke mostoleruar asgjë dhe asnjë interpretim të papërshtatshëm nga Rregullorja, siç ka ndodhur në të kaluarën.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitutional, i cili është një faktor shumë i rëndësishëm për përmirësimin e punës dhe të performancës në sistemin e burgjeve, duhet t'ju përmend marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, të cilën e kemi rishikuar për ta bërë më efikase; kemi vendosur një bashkëpunim të shkëlqyer me Avokatin e Popullit, duke bërë takime periodike, përveç vlerësimit të çdo lloj rekomandimi, gjetjesh apo çështjesh që ata parashitrojnë; me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, me OSBE-në e të tjerë.

Gjithashtu, kemi një bashkëpunim edhe me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, pikërisht për të adresuar atë perceptim të ekzagjeruar, folklorik ose publik për cilësinë e ushqimit dhe të shërbimit, pikërisht për të kontrolluar të gjitha subjektet nga buron kontrata, dhe ky autoritet ka kontrolluar ambientet tona të punës. Bashkëpunimi ynë vazhdon me Agjencinë e Kontrollit të Barnave dhe kjo agjenci na ka kontrolluar nëse të gjitha gjërat janë konform, nëse jo për t'i rregulluar në funksion të një trajtimi të plotë në zbatim të ligjshmërisë të çdo komponenti pune

dhe jete nëpër burgje. Po ashtu, kemi edhe një bashkëpunim ndërkombëtar, pasi Shqipëria sivjet u fut në shoqatën e Drejtorive të Përgjithshme të Burgjeve të BE-së (Euro Press), ku kemi pasur aktivitete të ndryshme, shkëmbime përvojash dhe praktikash shumë të mira. Dua të falënderoj partnerët tanë ndërkombëtarë, në mënyrë të veçantë ambasadorin anglez këtu në Tiranë për mbështetjen e tij, i cili në mënyrë të pandërprerë ka qenë një suporti yni, Ambasadën Amerikane për vëmendjen e shtuar dhe për rolin e spikatur që pati ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke e evidentuar atë jo thjesht si një magazinë për të burgosurit, por si një institucion që mundet dhe duhet të kryejë efektet e tij për çmontimin e organizatave kriminale. Kjo gjë mund të bëhet shumë thjesht, duke mos ua njohur fuqinë këtyre të burgosurve dhe duke i trajtuar si gjithë të tjerët, pavarësisht arsyes pse janë në burg dhe se çfarë veprë penale kanë kryer, pavarësisht fuqisë ekonomike dhe fizike kriminale apo mbështetjes nga jashtë burgut, ata në burg janë si gjithë të burgosurit. Ky është trajtimi njerëzor dhe human që ne u bëjmë të burgosurve pa diskutim sipas ligjit, por pa ju njohur asgjë nga sharmi kriminal që ata kanë. Kjo do të çojë jo vetëm në rritjen e sigurisë nëpër burgje, por edhe në vend, duke i çmontuar këto organizata kriminale siç thotë Ambasada e SHBA-ve pastaj siç e tha edhe kryeministri në parlament, ishte një mbështetje shumë e fortë për ne. Të dhënat statistikore që kanë lidhje me sa të burgosur janë për këtë apo atë vepër penale, sipas burgjeve, i keni, nuk po i lexoj.

Ermonela Felaj - Që nga koha që ju keni marrë detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, cila është problematika kryesore që keni hasur? Do të më interesonte kjo për të bërë diferencën në drejtimin e këtij institucioni, që siç e thatë edhe ju, është një lloj termometri, sepse, nëse ne duam të dimë edhe për situatën e sigurisë në përgjithësi në vend, burgjet e adresojnë një gjë të tillë.

Agim Ismaili - Së pari, aty ku unë kam pasur fokusin në sinkron të plotë me ministren e Drejtësisë, është sistemi i shëndetësisë në burgje, i cili realisht për arsye subjektive dhe objektive ka pasur mungesa dhe vazhdon të ketë. Kjo është një çështje, të cilën e kemi adresuar ndër të parat.

Së dyti, është lufta kundër diskriminimit pozitiv në burgje, jo luftë për të luftuar e shënjestruar njerëz, por për t'i dhënë fund praktikës që një i burgosur që është trim e vip zgjidh gjithçka, i merr të gjitha benefitet me të padrejtë, përdor sistemin për të qenë ai që pyetet, pra për t'i dhënë fund mendimit që burgju është konventa ku zgjerohet netuorku i atyre që janë aty, por gjithsecili të kryejë dënimin e vet, të mos ndjehet krenar pse ka ardhur në burg, por të mbarojë

dënimin, të rehabilitohet, të kthejë sytë nga Zoti dhe nga familja dhe të bëhet i denjë për shoqërinë siç historia botërore ka treguar.

Ka plot e përditshmja jonë, por unë u ndala në këto dy momente.

Ermonela Felaj- Ju thatë që jeni përqendruar te shëndetësia dhe të mospasja e privilegjeve për të dënuarit e veçantë, por trajtimi të jetë i njëjlojtë, sepse është e domosdoshme që ata ta ndjejnë ndëshkimin e dënimit me burgim, sepse edhe qëllimi i futjes në burg ky është, ndërkohë ju thatë që për herë të parë është futur *check-up*-i në burgje. A ka sot të dënuar që janë në spitalet private?

Agim Ismaili—Nuk kemi asnjë.

Ermonela Felaj- Kjo më duket një gjë e mirë.

Agim Ismaili - Nuk kemi asnjë, e kemi standardizuar këtë pjesë. Të burgosurit kanë të drejtë të zgjedhin mjekun sipas ligjit, por kjo e drejtë nuk është e pakufizuar, sepse ne kemi shërbim mjekësor të plotë 24 orë, pasi të kryhen verifikimet nga mjeku i burgut, shpeshherë edhe komision mjekësh dërgojmë aty. Të gjitha shërbimet mjekësore bëhen në burg, në spital të burgut, ose në QSUT, në fund mund të jetë një alternativë tjetër spitali privat, vetëm kur spitali shtetëror nuk ka mundësi teknike dhe shkencore.

Ermonela Felaj- Më vjen mirë që nuk ka asnjë rast të tillë.

Fjalën e ka zoti Duzha.

Luan Duzha- Faleminderit!

Ju dëgjova me vëmendje. Sa u përket fondeve, ju thatë se janë dyfishuar në vitin 2018 dhe në vitin 2019. A janë të pajisura me mjetet e logjistikës të gjitha IVP-të, duke filluar nga radiot, mjetet e transportit, shkopinjtë e gomave?

Sa i përket uniformës, ju thatë që është përmirësuar shumë, por unë do të doja të dija a kanë të gjithë punonjësit e policisë uniformë të re?

Sa i përket pagesës së vjetërisë të punonjësit të policisë, është një problem që ka vite që vazhdon, Policia e Burgjeve ka vite që nuk e merr vjetërsinë në punë, siç e marrin punonjësit e Policisë së Rendit. Çfarë është bërë për këtë?

Sipas rregullores, të dënuarit kanë të drejtë një numër të caktuar bisedash telefonike që ata mund të bëjnë kur ata janë në sektorë që mund të kontrollohen, por në dijeninë time, kur dalin në ajrim, aty ka edhe kartofonë, të cilët ata mund t'i përdorin dhe ku mund të flasin sa të duan. A është e ligjshme kjo? A i kontrollon njeri kur dalin se çfarë mund të thonë?

Disa burgje kanë brenda dyqane, ku të dënuarit mund të blejnë gjëra të ndryshme, disa nuk kanë. Sasia e ushqimeve në takimet që ata marrin është e përcaktuar me rregullore. A duket kjo një diskordancë ndërmjet burgjeve që kanë dyqane për sasinë e ushqimeve me pjesën tjetër të të burgosurve? Si mund të zgjidhet kjo?

A ka mundësi që, sipas shkallës së sigurisë, të dënuarit mund ta kryejnë dënimin afër vendbanimeve të tyre për vetë kushtet ekonomike që ata mund të kenë?

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Edhe unë kam dy pyetje. Te pyetja e parë që bëri zoti Duzha për pajisjet doja të dija nëse ka ecur projekti i investimit me mjetet e teknologjisë së avancuar.

Gjithashtu, i rikthehem pyetjes për uniformën nëse e kanë të të gjithë punonjësit e Policisë së Burgjeve. M marr shkas edhe nga disa praktika që janë konstatuar posaçërisht në lidhje me uniformat, të cilat policët detyrohen t'i sajojnë vetë.

Agim Ismaili – A janë pajisur me mjete logjistike IEVP-të? Po. Janë pajisur, janë bërë investime shumë serioze në këtë aspekt. Konkretisht për skanerë kontrolli, për metal detektorë, pa llogaritur investimet në pjesën e mbikëqyrjes me kamerë, janë rritur hapësirat e vëzhguara, koha e ruajtjes së regjistrimeve, sistemi radio e telefoni është përmirësuar dhe projekte të tjera ka në vijim. Është bërë një progres shumë i madh në këtë drejtim. Është lancuar edhe në medie që ka edhe një sallë qendrore komandimi ku lidhen IEVP-të për të kontrolluar një dinamikë të pandërprerë jo vetëm për çështje të sigurisë, por edhe çështje të përfitimit të të drejtave të të dënuarve nga Drejtoria e Përgjithshme. Pra, është progres i prekshëm real, pajisja me logjistikë, kemi marrë nga donatorët, nga Holanda dhe Anglia 5 mjete të reja, por edhe nga ambasadat në kuadër të projektit.

A janë të pajisur me uniformë të re të gjithë policët? Po, janë të pajisur me uniformë të re të gjithë policët. Uniformat, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, janë tri kategori, ka uniformë për ceremonial, për stërvitje, për punë. Tani të gjitha sipas kategorive nuk mund të themi që janë, për shembull, ato për ceremonial, por me pjesën tjetër janë pajisur të gjithë. Kemi të identifikuar 80 punonjës të rinj në Lezhë, që duhej të sistemoheshin sipas masave dhe numrave, por të gjithë kanë marrë uniformë nga shteti si asnjëherë më parë.

Sa i përket problemit të telefonave, është e vërtetë sipas akteve në fuqi të burgosurit kanë të drejtën e 8 telefonatave në muaj. Më përpara flitej me telefon fiks, ishte polici në këmbë që ruante. Sot nuk zbatohet puna e 8 telefonatave në muaj, sepse është pamundur për t'i menaxhuar

kartofonat e vendosura sipas kontratave në fuqi, të vendosura në ambiente ajrimi e të tjera, as nuk ke si të mbash radhën, është shumë dinamike kjo çështje, por janë marrë të gjitha masat që kjo punë do të marrë fund shumë shpejt. Të burgosurit nuk mund të marrin kë të duan në telefon, por kemi bërë listat që të burgosurit mund të flasin vetëm me 10 numra që ata i zgjedhin vetë, por duhet t'i deklarojnë se çfarë i kanë, me qëllim që të kryhen verifikime, dhe më pas përmes teknologjisë kjo nuk mund të zgjidhet me polic, por përmes teknologjisë. Tek një burg këtu në Tiranë e kemi në fazën e fundit implementimin për ta bërë funksional dhe pastaj do ta shtrijmë në të gjitha burgjet, në një kohë shumë të shpejtë. Kështu, përmes teknologjisë, do të kufizohet koha e telefonatës prej 10 minutash, do të kufizohen numrat dhe do të kufizohet numri i telefonatave në muaj. Për të burgosurit që janë nën masë e kemi zbatuar, sepse kontrolli ndaj tyre dhe mbikëqyrja është më e rreptë, është pjesë e një protokolli të fortë, por për të burgosurit masiv nuk është e mundur për kushtet që janë tani.

Sa i përket çështjes së dyqaneve në burgje, funksionojnë në këtë formë që dikush merr me qira një ambient, sipas një rregulli të caktuar, dhe ofron shërbimin për atë çfarë duan të blejnë të burgosurit. Pra, është një biznes. Diku ku ka pak të burgosur, kjo nuk është funksionale, sepse nuk del llogaria dhe nuk e merr askush me qira një gjë të tillë, megjithatë edhe për ata të burgosur që dikush e zgjidh në mënyrë ambulante dhe ofron mall. Nuk kemi ankesa nga të burgosurit që kanë para në llogari, duan diçka, por nuk arrijnë ta blejnë, në vijim është publikuar edhe në websit-in tonë prej kohësh. Shumë shpejt do ta zgjidhim këtë punë, do të përpiqemi të organizojmë një ankand që shërbimi i dyqaneve në burgje të bëhet me ankand sipas kriterëve, sepse në 24 burgje, 24 operatorë është më e vështirë për të vënë edhe standarde edhe cilësi edhe për të kontrolluar çmime, e të tjera. Është një çështje e adresuar si pikë e dobët do të bëjmë një proces super transparent për të arritur për të marrë më të mirën e mundshme për një shërbim modern të sigurtë e cilësor.

A mund ta kryejnë të burgosurit dënimin afër vendbanimit? Po, vendimi e Këshillit të Ministrave dhe aktet e tjera rregullative e përcaktojnë shumë qartë principin, ky është principi bazë, që duhet ta kryejë sa më afër vendbanimit që të jetë e mundur. Natyrshëm mund të përjashtohet nga kjo mundësi kur ka shkaqe shëndetësore që duhet të shkojë në seksione të veçanta ose spital burgu, ose kur ka çështje sigurie, sepse në çdo rast kur vendoset një i burgosur bëhet një verifikim për përshtatshmërinë nëse ka konflikte e të tjera. Supozohet një i burgosur i sigurisë së lartë, i cili mund të jetë nga Saranda, ka burg në Sarandë, por nuk mund të akomodohet atje assesi.

Në këtë pikë ndjehemi krenarë që kemi bërë maksimumin e mundshëm, por jo duke e zgjidhur transferimin drejt vendbanimit të të burgosurve, që bëri një kërkesë njëri, t'ia zgjidhim ose të mos themi gjëra të tjera, që edhe të mos i themi, i besojnë, për shembull, futu mik e mos themi mitmarrje e mit dhënie në lidhje me këtë çështje. Kemi bërë shumë lëvizje për t'i çuar pranë vendbanimeve duke i përcaktuar me kategori për një proces krejt transparent. Shumë lëvizje kemi bërë të kësaj natyre duke i përcaktuar me kategori. Kemi shqyrtuar kërkesat dhe rastet dhe janë zgjidhur, dhe është tejkaluar si problem. E kemi bërë vetë këtë rregullim ligjor. Kryesisht kemi transferuar të burgosur që janë në fund të kryerjes së dënimit me qëllim që edhe procesi i integritetit, edhe afrimi me familjen të jetë më intensiv që të përgatitet për liri, kemi bërë shumë lëvizje në Vlorë, në Fier, tanë që bëmë ndryshimin e kategorisë së burgut të Peqinit si burg i sigurisë së lartë, kemi bërë një rishpërndarje, tre të burgosur për të cilët kishim vend bosh në Berat i kemi çuar në Berat për t'i afruar me vendbanimin. Kemi qenë shumë sensibil në këtë drejtim, ka të dhëna, statistika dhe jemi shumë të kënaqur për këtë punë, duke vlerësuar shëndetin, konfliktet, sigurinë. Deri tani nuk kemi pasur asnjë incident.

Sa i përket vjetërsisë që është një problem, është adresuar në kuadër të ndryshimeve për ligjin “Për Policinë e Burgjeve” dhe është problem që besoj se shpejt do të zgjidhet, por tashmë dihet që qeveria e ka rritur pagën e Policisë së Burgjeve me 10 % dhe ka një parashikim konkret jo hipotetik për një periudhë të afërt kohore për ta barazuar. Pra, është një vëmendje reale e shtetit dhe qeverisë për Policinë e Burgjeve, përmendim këtu edhe kontratat për transportin e tyre në vendin e punës, që është një sukses shumë i madh, sepse të gjithë e dinë se dikur në një kryqëzim ishte një polic, i cili ishte i burgjeve. Përveç kësaj vlen të thuhet se është edhe një masë shumë e fortë për ta konsoliduar këtë trupë dhe për t'i dhënë edhe njerëzve një motiv më shumë. Udhëzimi i ministrit, në fakt, ka qenë gjithmonë në frymën e ligjit për ndalimin e transferimit të policëve 45 kilometër larg vendbanimit. Kemi parë e dëgjuar çudira që një polic me rrogë dikur para disa vitesh 40 mijë lekë i del transferimi nga Shkodra në Korçë. Pa asnjë logjikë. Kjo, pas udhëzimit të ministrit, tani ka ndryshuar. Është frenuar e zbatojmë udhëzimin, ne e kemi të brendshme këtë çështje e kemi rikuperuar shumë dhe kemi bërë korrigjime për këto gabime që lidhen me transferimin e stafit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Spartak Braho - Faleminderit!

Duke menduar që u ezauruan disa pyetje, unë do të vlerësoja pozitivisht veprimtarinë e institucionit tuaj. Keni qenë i suksesshëm edhe në AKU, por burgjet nuk janë AKU-ja, ti e di shumë mirë, por ke krijuar një ekip shumë të mirë atje së bashku me drejtorin e policisë, ndonëse problematika në burgje është komplekse, nuk është burgu as resort, as kompleks resortesh turistikë, burgu ndeshet me problematika dhe me gjëra të çuditshme, të papara ndonjëherë dhe të paparashikuara. Megjithatë, unë pozitivisht përcjell një opinion vlerësues për ju.

Lidhur me pyetjet, unë do të prek disa çështje.

Së pari, si e gjykoni ju legjislacionin aktual, që rregullon marrëdhëniet e institucionit tuaj? A duhet të rishikohet? A ka nevojë për vendime afatshkurtra apo afatgjata?

Së dyti, a jeni në dijeni të ndonjë vendimi të marrë nga Ministria e Drejtësisë për amnisti të paralajmëruar?

Së treti, shpeshherë dëgjojmë edhe nga mediet, por edhe në rrugë të tjera, se punonjës të Policisë së Burgjeve angazhohen në veprimtari kriminale ose bëhen pre e veprimtarive kriminale. Për shembull, rasti i Kavajës ishte rast flagrant. Në këtë kuadër, a duhet të përfshihen punonjës të Policisë së Burgjeve në vetting? Pra, a mendoni se edhe punonjës të Policisë së Burgjeve duhet të përfshihen në vetting, të paktën drejtuesit kryesorë?

Së katërti, kush e shoqëroi Izet Haxhinë ditët e fundit? U bë një zhurmë e madhe, mund të jetë edhe e sajuar, por unë dua të di a e shoqëroi Policia e Burgjeve apo Policia e Shtetit? Kjo sepse u ngrit një pretendim sikur donin ta vrisnin, por unë nuk e mora vesh?

Pyetja tjetër është: a ka pasur trajtime preferenciale, siç thuhet, për shembull, për të burgosurit preferencialë apo për këta të fortët? Ka zëra se disa prej tyre, nuk dua të përmend emra, trajtoheshin me kushte speciale. A ekzistojnë më këto gjëra? Këto ishin pyetjet e mia në përgjithësi.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Braho!

Dua që të kem mirëkuptimin tuaj dhe të zotit Ismaili, që të lejojmë edhe zotin Zeneli të bëjë pyetjet e tij dhe më pas t'i marrim të gjitha përgjigjet bashkë. Meqenëse zoti Zeneli ka një impenjim tjetër, duhet ta lejojmë që të bëjë pyetjet, duke qenë se është edhe nënkryetari i këtij komisioni.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

E falënderoj drejtorin për prezencën e tij këtu në këtë seancë dëgjimore! Burgjet shqiptare kanë shumë problematika, por dua t'ju pyes për dy gjëra specifike. Para disa ditësh ka ndodhur një

ngjarje në burgun e Shënkollit, ku, nga informacionet që ne kemi marrë nëpërmjet telefonave, ka ndodhur një situatë jo e favorshme që janë shkelur të drejtat e disa të burgosurve. Madje, unë disponoj edhe emrat e tyre. Pra, bëhet fjalë për Shkëlzen Durakun dhe Mario Pjetrushin, të cilët janë rrahur dhe janë në gjendje të rëndë.

Gjithashtu, gjëja tjetër që dua të di ka të bëjë me burgun Peqinit, ku nga 361 punonjës, vetëm 50 punonjës janë nga Peqini. Çfarë kriteresh janë marrë parasysh lidhur me këtë problem? Mua më duket një lloj diskriminimi që ju u bëni qytetarëve të Peqinit, ku papunësia në atë qytet është në shifra alarmante. Unë dua të di: çfarë masash janë marrë për rastin e parë, për dhunimin e të burgosurve nga forcat policore që ju drejtoni?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjala është për zotin Ismaili.

Zoti Ismaili, mund të filloni t’u përgjigjeni pyetjeve të zotit Braho dhe më pas pyetjeve të zotit Zeneli.

Zoti Braho kishte merakun që t’i bënte pyetjet, por përgjigjet do t’i marrin kolegët e tij të grupit, që janë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të kuptojmë se Grupi Parlamentar Demokrat është i involvuar në disa ndryshime kohët e fundit.

Agim Ismaili – Zoti Braho, në lidhje me pyetjen për legjislacionin aktual, nëse ka nevojë për amendime afatshkurtra dhe afatgjata, unë do të përgjigjem në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ligji për të drejtat e trajtimit të të dënuarve, por edhe ligji për Policinë e Burgjeve janë në proces ndryshimesh, ku ka disa risi interesante për të cilat nuk po zgjatem. Në lidhje me legjislacionin dua të them se që nga viti 1998 ka akte nënligjore që nuk kanë dalë ende për sistemin burgjeve. Për shembull, për punësimin e të burgosurve po punohet fort për t’u adresuar si çështje, por jo vetëm. Gjithashtu, ka nene të veçanta, që, siç e thashë, nuk janë zbatuar asnjëherë që nga viti 1998 e këtej. Megjithatë, nevojat për ndryshime në legjislacion janë adresuar dhe janë në proces.

Natyrisht, ne jemi strukturë varësie e Ministrisë së Drejtësisë dhe jemi të angazhuar, për aq sa na takon, për çështjen e amnistisë, ku, madje jemi shumë aktivë me grupet e punës për pjesën takuese, duhet të përfshihemi.

A është e angazhuar Policia e Burgjeve në veprimtari kriminale? Ngjarja e fundit në Kavajë fillimisht bëri bujë, sepse ishte një ngjarje jashtë detyre, pra që në dukje nuk kishte lidhje me detyrën, për aq sa jemi informuar dhe ne kemi marrë të gjitha masat duhura për rastin. Natyrshëm, nga ajo që mësuam nëpërmjet medies, nisur nga fakti se ka edhe një çështje për përfshirje të mundshme në trafikim droge, mund të them se ka një risk të shtuar që punonjësit e Policisë së Burgjeve të përfshihen, në rastin konkret, në trafik droge, për t'u dhënë të burgosurve atë që ata duan, për ta shitur apo për ta tregtuar, gjithashtu edhe për të futur sende të ndaluara.

Unë e thashë në fjalën time hyrëse lidhur me futjen e sendeve të ndaluara në burgje se në vitin 2016 u miratua ndryshimi i Kodit Penal, neni 324/a, sipas të cilit në paragrafin e dytë kriminalizohen në mënyrë të posaçme ata, që bashkëpunojnë për t'i futur këto sende të ndaluara në burgje. Në fakt, nuk ka asnjë rekord të tillë, pra të jetë dënuar dikush për këto veprime dhe askush nuk mendon ndryshe, sepse këto sende janë futur nëpërmjet veprimit apo mosveprimit, në kundërshtim me ligjin, nga punonjësit e policisë. Pra, kjo çështje duhet adresohet në bashkëpunim edhe me prokurorinë dhe ne jemi në këtë proces.

Ne kemi një bashkëpunim të shtuar me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve. Unë nuk raportova këtu statistikën, ndonëse i kemi këto statistika, si dhe për masat disiplinore që kemi marrë. Përveç kësaj, jo vetëm SHKB-ja, por edhe ne si Drejtori e Burgjeve, kemi bërë kallëzime penale ndaj punonjësve tanë. Para pak kohësh një ngjarje e tillë është bërë edhe publike për dy drejtorë burgjesh, të cilët janë kallëzuar penalisht pikërisht për shkelje të kësaj natyre. Pra, është sfidë e shoqërisë dhe e të gjitha institucioneve, përfshirë edhe institucionit që unë drejtoj, lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër atyre që janë në sistem dhe përfshihen në veprimtari kriminale.

A duhet të bëhet veting? Nuk është marrë asnjë polic në punë, në këtë periudhë, pra prej 2 vjetësh, pa kaluar verifikimin e përshtatshmërisë nga institucionet përkatëse. Pra, janë bërë verifikime, për aq sa ka qenë e mundur, të domosdoshme dhe të duhura për përshtatshmërinë e tyre.

A mund të thellohet ky veting? Ligji për vetingun në Policinë e Shtetit nuk e parashikon përfshirjen në veting të trupave të drejtuesve të policisë. Nëse do të bëhej kjo gjë do të ishte ishte një iniciativë shumë e mirë për të gjithë drejtuesit e tjerë, sepse kjo është ndihmë për sistemin burgjeve, është ndihmë për pastërtinë e figurës së drejtuesve dhe për të rritur garancinë, që të mos prekemi ose të parandalojmë, në mënyrë që të mos bëhen motiv për korrupsion.

Për çështjen e Izet Haxhisë, nuk është fjala që ta bëjmë mistike, sepse këtu janë prezent edhe mediet, por si për çdo të burgosur apo të paraburgosur me një rrezikshmëri të caktuar, sipas klasifikimit, ka një program masash. Lëvizjet e këtyre personave bëhen nga punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe Policisë së Shtetit. Gjithçka bëhet konform ligjit dhe deri tani nuk ka ndodhur asnjë aksident, pastaj mediet kanë punën e tyre, të cilën ne nuk e pengojmë dot.

A ka pasur trajtime preferenciale për të burgosurit? Në fakt, janë bërë deri në folklorike disa përshkrime për trajtimet, që kanë qenë preferenciale për të burgosurit, por, gjithsesi, mund të them se ka pasur disa trajtime preferenciale për të burgosurit. Ky trajtim preferencial ka konsistuar në numrin e takimeve që mund të bënin të burgosurit me miqtë, të afërm e të tjerë; në qëndrimin në dhomën e veçantë; në ushqime të veçanta, në telefonata, pastaj, kuptohet, edhe në sende të ndaluara, që nuk guxonin t'i kontrollonin, i kontrollonin pak ose aspak e të tjera. Pra, patjetër që ka pasur trajtime preferenciale. Mund të them se këto raste kanë marrë goditje shumë të fortë, kemi ndryshuar edhe mentalitetin lidhur me këtë aspekt. Konkretisht takimet janë bërë sipas ligjit dhe ne nuk kemi ndryshuar asgjë për sa i përket ligjit apo akteve të tjera. Ligji ka parashikuar për të burgosurit 4 takime në muaj dhe asnjë i burgosur nuk bën më shumë se 4 takime në muaj. Gjithashtu, ligji parashikon që drejtori i burgut mund të lejojë takime shtesë për arsye të veçanta dhe për arsye të veçanta takohen vetëm ata, që kanë arsye të veçanta. Për saktësi: në muajin gusht arsye të veçanta nga 5500 të burgosur kishin vetëm dy të burgosur dhe vetëm këta dy të burgosur kanë bërë takime shtesë, ndërkohë që më parë numri i të burgosurve, të cilët kërkonin takime për arsye të veçanta, ka qenë një mijë vetë. Pra, ka marrë goditje trajtimi preferencial dhe jemi të vendosur që ta thellojmë këtë gjë, që ata të jenë të burgosur si gjithë të tjerët me të gjitha të drejtat siç e parashikon ligji, por kurrësi nuk mund të kenë favore apo privilegje më shumë se sa parashikon ligji.

Ermonela Felaj – A mund të bëj një saktësim, pa filluar përgjigjet e pyetjeve të tjera. Këtu para kam statistikën e Prokurorisë së Përgjithshme, raportin vjetor për gjendjen e kriminalitetit. Më bëri përshtypje që ju përmendët disa herë nenin 324/a, që është vepra penale e futjes ose e mbajtjes së sendeve të ndaluara në burgje, ose në institucionet e paraburgimeve që janë më shumë se burgjet. Në fakt, në vitin 2018 raportohet se kemi 231 procedime, pra nga të gjitha prokuroritë e Shqipërisë të shkallës së parë janë regjistruar 231 procedime, ku 125 nga këto procedime kanë shkuar në gjykatë dhe janë dënuar 127 vetë. Unë nuk e di nëse këta persona janë të dënuar, të cilët janë kapur me sende apo janë punonjës të burgjeve. Ndoshta këtu duhet të hedhim pak dritë për të

kuptuar që futja e këtij neni pati rëndësi. Unë mund t'ju përmend edhe shifrat e vitit 2017 që janë edhe më të larta, janë 317 procedime dhe janë dënuar 128 persona për mbajtjen e sendeve të ndaluara në burg.

Agim Ismaili – Futja e këtij neni ka pasur rëndësi të jashtëzakonshme në uljen e numrit të sendeve të ndaluara në burg. Ne kemi nxjerrë statistika dhe i kemi adresuar lidhur me këto sende të ndaluara dhe ka çuar në një rënie drastike. Në fakt, kjo dispozitë hetimi, që ka ndodhur pas vitit 2016, sipas kësaj vepre penale, në gjykimin tonë nuk ia kanë arritur qëllimit për shkak se këto sende vazhdojnë të futen në burg. Maksimumi këto sende janë futur në burg nga ndërhyrjet familjare, por nuk janë kapur asnjë oficerë policie, të cilët me veprime apo mosveprime të kenë lejuar hyrjen e sendeve të ndaluara në burg. Pra, dënime sipas paragrafit të dytë të këtij neni nuk kemi.

Ermonela Felaj - Po unë e kam këtë të dhënë.

Agim Ismaili – Edhe paragrafi i parë i këtij neni, nisur nga niveli i hetimeve, nuk ka rezultuar shumë i suksesshëm, sepse për të bërë një kontroll në burg duhet të hapësh shumë dyer. Më pas ndodh shpesh që telefonin mund t'ia kapim të burgosurit A dhe futjen e këtij telefoni në ambientet e burgut e merr përsipër i burgosuri B, i cili mund të jetë dënuar me burgim të përjetshëm dhe nuk e ka problem...

Ermonela Felaj – Ju mendoni se është çështje e ligjit, që duhet adresuar më mirë, e përmbajtjes së veprës, apo është çështje e hetimit?

Agim Ismaili - Duhet bërë hetime, sepse nëse futet një celular dhe verifikohet se me kë ka folur i dënuari, ai mund të thotë se ka folur me familjarët dhe do të përpiqet të bashkëpunojë për të marrë dënimin më minimal. Ky i dënuar do të thoshte: “Ja ku e kam celularin, ja ku janë edhe sms-të, që ua dërgova familjarëve të mi”.

Ermonela Felaj – Dakord, por a nuk ka qenë e përfshirë Policia e Burgjeve, në bashkëpunim me prokurorinë, në hetimin e këtyre çështjeve?

Agim Ismaili – Policia e Burgjeve nuk ka shërbim të Policisë Gjyqësore, se është SHKB-ja struktura që e kryen këtë veprimtari. Unë nuk e kam këtë të dhënë, por jo gjithmonë SHKB-ja ka qenë e përfshirë në këto hetime. Unë mund të them se hetimet që bëhen konfirmojnë vetëm faktin nëse është kapur një celular apo jo. Kjo është çështje faktesh dhe ky i dënuar mund të gjykohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, verifikohet si u kap ky celular, çështja dërgohet në

gjykatë, kurse për sa i përket hetimit verifikohet se me kë ka folur i dënuari, çfarë bisedash ka bërë e të tjerë.

Ermonela Felaj – Pra, që t’i nënshtrohet ekspertimit të telefonit e me radhë...

Agim Ismaili - Në radhë të parë hetohet se i kujt është celulari, sepse autorësinë e telefonit mund ta marrë përsipër një i burgosur me dënim të përjetshëm, ose e marrin të burgosur vulnerabël, që mund të jenë të varfër, të cilët qëndrojnë pak si nën tutelë ndaj më të fortëve dhe vetësakrifikohen për ata “të madhërishtit” e të tjerë. Në këtë aspekt hetimet do të kishin një progres shumë të madh në lidhje me sigurinë kundër kriminalitetit.

Ermonela Felaj – Mund të vijojmë me përgjigjet për pyetjet që bëri kolegu Zeneli, lidhur me situatën në burgut e Peqinit, si dhe për rastin që ai aludoi që ka ndodhur në Shënkoll të Lezhës, të cilin nuk e dimë nëse është i vërtetë.

Agim Ismaili – Në burgun e Shënkollit në Lezhë nuk ka pasur dhunë ndaj të burgosurve. Ka qenë një ngjarje, e cila, në fakt, me të drejtë ose jo (deputetët kanë bërë statute në *facebook* e të tjerë), mori përmasa, por për ne nuk ishte ndonjë ngjarje e rëndë. Ka incidente, keqkuptime e të tjera si këto, por për ne nuk quhen ngjarje me përmasa të mëdha, ashtu siç reflektohen në medie. Unë mund të them se në këtë rast se nuk është përdorur dhunë, por ka pasur një rebelim, ku gjithçka është bërë nga disa të burgosur lidhur me çështjen e orarit të veprimeve, që dihet se ka një protokoll shumë të fortë. Orari i veprimeve është unik në të gjithë sistemin e burgjeve dhe askund nuk kemi pasur kontestime, që gjoja nuk jemi njoftuar më parë, përveç atij seksioni, një ndër seksionet me më shumë të burgosur ndër 24 burgjet që janë në Shqipëri. Pra, për sa i përket këtij rasti ne kemi vepruar në mënyrë profesionale dhe jo si një organizatë e mbyllur, por si organizatë e hapur. Konkretisht po përmend veprimet që ne bëjmë lidhur me raste të tilla. Kur ka incidente më të vogla ne njoftojmë menjëherë Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve. Pra, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve nuk është si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe fokus të veprimtarisë ne kemi unitetin dhe kontradiktën midis njëri-tjetrit, sepse ata na raportojnë ne te Ministria e Drejtësisë. Pra, ata bëjnë raporte, për sa i përket punës sonë, te Ministria e Drejtësisë. Njerëzit mund të mendojnë se të dyja këto institucione të shtetit janë, por, në fakt, ata janë për të na monitoruar ne. Ata kanë bërë raportet e tyre dhe kanë referuar në prokurori materiale kundër të burgosurve për shkeljet që ata kanë kryer e të tjerë. Jo vetëm kaq, por edhe ne si Drejtori e Përgjithshme e Burgjeve për 4 prej të burgosurve që spikasin si organizatorë dhe nxitës kemi njoftuar menjëherë prokurorinë, e cila i ka zhvendosur këta të dënuar nga Lezha në Fier. Pra,

prokuroria ka njoftuar menjëherë gjykatën dhe ne kemi vendime gjyqësore ku janë shqyrtuar personalitetet e ndryshme të tyre, shkeljet e tyre dhe janë marrë të gjitha masat. Pra, gjykata e ka konfirmuar urdhrin e drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për mbikëqyrje të posaçme për këta të dënuar për një hark kohor 3 muaj në burgun e Fierit aty ku i kemi vendosur. Pra, këta të burgosur janë zhvendosur nga burgu i Lezhës në burgun e Fierit. Kjo është gjithçka që ne kemi bërë, më pas hetimet më të thelluara i vazhdon prokuroria, madje edhe Avokati i Popullit, pasi dje kemi pasur një takim të.

Ne administrativisht nuk e kemi mbyllur ngjarjen pasi presim edhe konkluzionet e institucioneve të tjera dhe, nëse ka tejkalim force të izoluar nga njëri apo tjetri, patjetër që do të reagojmë institucionalisht ashtu siç duhet. Ne e refuzojmë dhunën dhe e kemi anashkaluar si institucion, madje edhe si shoqëri, sepse nuk e quajmë më si formë menaxhimi, pasi kemi në dorë fuqi shumë më të madhe se dhuna, që është zbatimi i ligjit dhe i rregullores. Nëse të burgosurit zbatojnë rregulloren kanë përfitime të jashtëzakonshme ligjore nga favoret që u jep ligji. Ne ua kemi bërë të qartë dhe ua bëjmë të qartë çdo ditë se, për shkak të shkeljeve që ata mund të bëjnë do të humbasin shumë gjëra, ndaj nuk kemi nevojë që të përdorim dhunë, as nuk e kemi për kulturë institucionale dhe e refuzojmë në mënyrë kategorike.

Në lidhje me burgun e Peqinit, unë nuk kam dijeni për atë statistikë se ku banojnë policët e burgut të Peqinit. Ne kemi bërë një proces testimi dhe konkurrimi është shumë transparent, sepse e kemi mediatizuar dhe e kemi hedhë edhe në *websit*-in. Aplikantët nuk i ka zgjedhur asnjë nga pyetja: nga je? Kjo pyetje nuk është bërë fare, ne vetëm kemi shpallur vendin vakant.

Ne do të bëjmë një konkurs të ri për polic burgjesh në rrethin e Peqinit. Kush është i interesuar, mund të vijë të konkurroj në vendet vakante, sepse dikush ka dalë në pension dhe dikush është larguar me masë disiplinore e të tjera. Pra, mund të vijë kush të dojë që të monitorojë se si selektohen konkurrentët e Peqinit.

Ermonela Felaj – Faleminderit për përgjigjen!

Ndërkohë që kam një sugjerim për kolegët deputetë, të cilët bënë pyetje rreth situatës së fundit të ndodhur në Shënkoll, që duhet të jenë më të kujdesshëm në marrjen e telefonatave të tilla, sepse nuk mund të kesh të tilla kontakte, prej të cilave mund të penalizohesh nesër. Pra, janë kontakte të papërshtatshme, prandaj telefonatat duhen adresuar tek Avokati i Popullit, i cili ka komisionerin përkatës që monitoron burgjet dhe për çdo lloj ankese ndaj punonjësve të burgjeve,

mekanizmi është i ngritur dhe ka vite që vepron. Drejtori e shpjegoi shumë mirë që është më shumë se një mekanizëm dhe është më shumë se një sy për situatën që ndodh në burgje.

Fjalën e ka zonja Dralo dhe pastaj zonja Duka.

Artemis Dralo – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti drejtor!

Unë kam dy komente. E para është në terma të përgjithshëm. Në bazë të informacionit që keni sjellë, për sa i përket inspektoratit ekzekutiv të veprave penale në Krujë, ju thoni se ka 40% mbipopullim, që do të thotë se janë 80 të burgosur më shumë, pasi, sipas jush, është i vetmi institucion ku janë akomoduar të sëmurë me mjekim ose të moshuar. Si pasojë janë transferuar në dy godina të rikonstruara në Lezhë, por vihet re se edhe atje ka 47 të dënuar mbi kapacitetet, pra 13% më shumë se kapaciteti normal që mban ky burg. Si janë akomoduar dhe për sa kohë do të qëndrojnë në ato godina?

Pyetja e dytë lidhet me procesin e ri të integritit social të të burgosurve në lidhje me zhvillimin moral, edukativ, por edhe atë profesional të njerëzve që janë në ato burgje. Konkretisht, dua t'i referohem burgut të Tepelenës, në të cilin ka vetëm 2 të burgosur mbi kapacitetin normal. Në këtë burg janë 107 punonjës dhe raporti i punonjësve social me të burgosurit është 1 me 30. Nga informacioni që kemi është se procesi i integritit nuk është në nivelet e dëshiruara në Tepelenë, madje shpeshherë është i cenuar. Çfarë plani, projekti apo iniciative është ndërmarrë për të adresuar nevojat e veçanta të të burgosurve në aspektin e riintegritit të tyre social, që lidhet me aktivitete dhe programe të ndryshme, përveç aktiviteteve që ata kanë gjatë orëve të tyre të ajrimit, ose të vetmen kënaqësi që ata kanë me vizitat, të cilat nuk janë më shumë se 4 në muaj?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dralo!

Vetëm për saktësinë e informacionit, meqenëse i referuat pyetjen tuaj zotit Ismaili, ky është një informacion që ne ia kemi kërkuar Ministrisë së Drejtësisë, e cila na e ka vënë në dispozicion në qershor të këtij viti. Aty na rezulton se janë disa burgje, jo më shumë se 3, që kanë një mbingarkesë të vogël, ndërsa të tjerët janë nën normën e parashikuar për kapacitetet e të burgosurve. Pra, është e vërtetë ajo që zoti Ismaili shprehu, që nuk kemi mbipopullim të burgjeve, sepse edhe ndërtimi i burgjeve të reja e ka lehtësuar situatën e mbipopullimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është e vërtetë edhe ajo pjesë kur pyetët për Krujën, por zoti Ismaili mund të na sqarojë më mirë. Meqenëse jemi në këtë pikë, ku u pyet për burgun e Krujës, dua të shtoj edhe unë dy pyetje. Burgu i Zaharisë a është mbyllur apo ekziston?

E dyta, ju thatë se keni 237 veta me mjekim të detyruar. Ku janë vendosur këta të burgosur? A është adekuat trajtimi i tyre, sepse po vijohet të ketë probleme? Ndoshta njerëzit nuk janë të informuar, por ka probleme, si ajo e goditjes dhe kryerjes së veprave të dhunës nga persona, që nuk janë të përgjegjshëm përpara ligjit. Shumë shpesh abuzohet me këtë pjesë dhe këta persona nuk çohen përpara gjykatës apo prokurorisë që të vendoset procedura për një masë mjekësore të detyruar, por lihen të lirë dhe ata vazhdojnë të përbëjnë rrezik për shoqërinë. Jo shumë larg, por pak kohë më parë, të afërmit e një kolegeje deputete janë goditur nga një person i tillë i papërgjegjshëm, i cili vijon të ngelet jashtë. Habia ime është: akoma nuk janë të informuar punonjësit e Policisë së Shtetit, të prokurorisë dhe gjykatës? Ne kemi ku t'i vendosim këta persona, natyrisht që nuk i çojmë në burg, sepse ata nuk janë të përgjegjshëm dhe nuk mbajnë përgjegjësi penale, por ama kemi institucione ku mund të trajtohen.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina –Avokati i Popullit, në raportimin që ka bërë përpara Kuvendit, burgun e Zaharisë, të Krujës, të Kukësit, të Tepelenës dhe të Sarandës, nëse nuk gaboj, i ka konsideruar si të papërshtatshëm për shkak të amortizimit dhe ka rekomanduar mbylljen e tyre. Nga ana tjetër, ju thatë se keni bërë rikonstruktiv të godinave dhe të ambienteve. Çfarë masash janë marrë për këto burgje në këtë drejtim?

Për sa i përket faktit që jeni duke rishikuar legjislacionin, dua të di a është marrë në konsideratë që ditët e punës së të dënuarve të njihen si vjetërsi pune për efekt pensioni në pleqëri? Këto kisha.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Ismaili.

Agim Ismaili – Në lidhje me çështjen e mbipopullimit, e përsëris që nuk ka mbipopullim në sistemin penitenciar shqiptar. Ai rast që ju përmendët në Tepelenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përmendët edhe Tepelenën dhe thatë se ka 2 të burgosur më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Të dëgjojmë përgjigjen, pastaj, nëse ka diçka për të sqaruar mund ta bëjmë.

Agim Ismaili – Unë e ilistrova edhe kur fola për transferimet afër vendbanimeve, pra jemi kujdesur që, nëse ka 3 vende bosh, për shembull, në Berat apo Tepelenë, t'i transferojmë të burgosurit pranë vendbanimit. Pra, nëse ka pasur 2 veta mbipopullim në qershor, kur keni marrë ju statistikën, kjo gjë mund të ndodhë edhe sot, sepse mund të arrestohen 20 persona, për shembull, në Tepelenë, dhe atë natë do të ketë mbipopullim. Por nuk ka mbipopullim nëpër burgje.

Në Krujë tashmë është investuar dhe është vendosur për të transferuar personat që janë nën mbikëqyrje me masë mjekësore të detyruar, në dy godina që janë nën juridiksionin e Ministrisë së Shëndetësisë, që lidhet edhe me shërbimet mjekësore ndaj tyre. Nuk është kryer ende ardhimi i këtyre godinave, por është një proces që do të mbarojë shumë shpejt dhe do të zgjidhet përfundimisht ky problem.

Ndërkohë për gratë që janë me mjekim të detyruar, janë akomoduar në spitalin e burgjeve në kushte dhe shërbim mjekësor shumë të mira, sepse është bërë një investim serioz, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, ku gjeografikisht janë në të njëjtin ambient, në QSUT. Pra është zgjidhur edhe kjo pjesë delikate.

Për të vazhduar me çështjen e kushteve në Sarandë, në fakt, Ministria e Drejtësisë, ka nxjerrë një urdhër për kalimin e këtij burgu në konservim, pra mbyllje të përkohshme, ndërkohë që është e lartë vëmendja për rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe për shqetësimet tuaja. Në burgun e Sarandës për të rritur standardet, sapo kemi mbaruar një investim dhe aktualisht sot nuk ka asnjë të burgosur për shkak se jemi duke bërë kolaudimin për të dorëzuar veprën, për kryerjen e ndryshimeve ashtu siç janë rekomanduar nga Avokati i Popullit, pra për rritjen e standardeve.

Në Lezhë, sapo e thashë, investimet në godina kanë mbaruar dhe është bërë një investim serioz.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Kukës, pa dyshim që ka pasur investime, ne do t'ju informojmë me prova dhe fakte.

Për çështjen e ditëve të punës, ligji aktual për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, datë 16.04.1998, ka pësuar disa ndryshime, por aktet nënligjore që lidhen me punësimin, që është një VKM që duhet të dalë për të rregulluar këtë pjesë, nuk janë përfunduar. Ligji jep parimet që puna në burgje bazohet në vullnetarizëm dhe nuk mund të jetë e detyruar, detyrimisht nuk mund të penalizohen, pra janë si çdo punonjës tjetër për sa u takon të drejtave, por nuk janë të rregulluar

me akte nënligjore. Sot zbatohet dekreti i Presidentit i vitit 1998, ku shpërblen punën me 900 lekë të vjetra në muaj kur realizon normën dhe parashikon falje 3.9 ditë, e cila aplikohet. Ajo që nuk është bërë që nga vitit 1998, po e bëjmë tani dhe jemi në proces të draftimit të VKM-së, të cilën pothuajse e kemi definuar. Unë besoj se do të zgjidhet njëherë e mirë kjo punë.

Për sa i përket çështjes së punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve u është drejtuar organizatave kryesore që përfaqësojnë biznesin në Shqipëri që të sjellin projektide për të bashkëpunuar dhe për t'i kthyer sytë nga ky treg pune. Pra, i është shtrirë dora për bashkëpunim, por ende nuk kemi marrë ndonjë reagim prej tyre. Meqenëse nuk e kemi aktin nënligjor gati, nuk u kemi kërkuar “llogari” atyre. Pra, ne e dimë si problem dhe përpjekjet për të komunikuar me organizatat e biznesit është një tregues që nuk është diçka e fjetur, por është në agjendën tonë kryesore.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ismaili, për përgjigjet!

Fjalën e ka zoti Harusha dhe pastaj zoti Vorpsi.

Luan Harusha – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ismaili, unë kam dy pyetje.

E para, fëmijët e mitur që janë nën moshën 14 vjeç, të cilët kryejnë vepra penale dhe ligji nuk i penalizon, a mendoni se duhet hapur një shkollë riedukimi?

Ermonela Felaj – Është çështja për fëmijët nën moshën 14 vjeç, të cilët nuk mbajnë përgjegjësi penale dhe për këtë arsye nuk dënohen. Për këtë situatë është duke pyetur zoti Harusha, që të mos e paragjykojmë, të dëgjojmë edhe pyetjen tjetër dhe pastaj marrim përgjigjen

Luan Harusha – E dyta, kam në pyetje për burgun e Shkodrës. Përpara disa kohësh ka pasur një testim për punonjësit e burgut, aplikantët që kanë kaluar testimin kanë marrë uniformën dhe ka disa muaj, ndoshta një vit, që nuk kanë filluar punën. Çfarë përgjigje mund t'u japim këtyre personave?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, koleg!

Po, zoti Ismaili.

Agim Ismaili – Kjo nuk është çështje...

Ermonela Felaj – Nisur nga trajtimi që ju u bëni të miturve në burgun e Kavajës...

Agim Ismaili – Po u bëjmë një trajtim shumë të mirë, por nuk është çështje që na përket neve.

Ermonela Felaj – Pra, në planet e reformës penitenciare që ka bërë Ministria e Drejtësisë, sepse kemi edhe këshilltarin, këtë situatë si mendoni ta zgjidhni, sepse ka të mitur të përfshirë në krim?

Edis Ibrahim – Personat që janë nën 14 vjeç nuk kanë përgjegjësi penale, por, në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, për këta persona është parashikuar të ngrihen institucione të veçanta, siç ka qenë më përpara institucioni i riedukimit, sepse edhe ligji parashikon që duhet të ngrihet një institut, i cili nuk është burg, pra nuk do të jetë nën menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgut, por nën Ministrinë e Drejtësisë. Aktualisht ka dalë edhe VKM-ja për ngritjen e qendrës për parandalimin e krimeve tek të miturit dhe është duke u ngritur struktura në drejtorinë përkatës, e cila do të menaxhojë të gjithë situatën e të miturve që do të trajtohen në këtë institut. Ne jemi duke parë mundësinë e ngritjes së këtij instituti në afërsi të Tiranës, për shkak se numri më i madh i personave janë në afërsi të Tiranës dhe Durrësit, sepse edhe ligji e parashikon që qendrat duhet të ngrihen në afërsi të familjeve të tyre. Pra, këta fëmijë duhet të vazhdojnë të mbajnë kontakte me familjarët dhe duhet të vazhdojnë jetën e tyre shkollore jashtë këtij institucioni, pra trajtimi i tyre duhet të jetë sa më social, por që do të monitorohet nga stafi në këtë institucion. Pra, është një institucion rehabilitimi miqësor për këta të mitur. Ne jemi në bashkëpunim me shumë partnerë ndërkombëtarë për të na mundësuar ngritjen e këtij instituti sa më shpejt, megjithëse është parashikuar edhe në buxhetin e shtetit që ky institut të ngrihet sa më shpejt.

Ermonela Felaj – A do të ndërtohet rishtazi apo keni përcaktuar godinën, e cila do të përshtatet për këtë qëllim?

Edis Ibrahim – Ne jemi duke studiuar dy modele, që ta bëjmë sa më të shpejt dhe të jetë funksional. Jemi duke parë mundësinë për gjetjen e një godine ekzistuese për ta përshtatur, sepse kërkon më pak kohë dhe më pak investime. Por në rast se nuk gjendet mundësia për modelin e parë, kemi parashikuar edhe ngritjen e këtij instituti nga e para në një nga pronat e Ministrisë së Drejtësisë. Është bërë një studim fizibiliteti për ndërtimin e këtij subjekti nga e para. Pra, i kemi parë të dyja modelet për ta ngritur sa më shpejt.

Ermonela Felaj – Faleminderit, për informacionin!

Fjala është për zotin Ismaili, për përgjigjen e pyetjes për burgun e Shkodrës.

Agim Ismaili – Nuk ka polic që i ka dalë urdhëri për punë dhe nuk janë pranuar në punë.

Ermonela Felaj – Zoti Harusha e ka pasur shqetësim të hershëm, nuk e ka sot që ju keni ardhur në komisionin tonë.

Luan Harusha – Drejtor, aplikuesit kanë fituar testin dhe kanë marrë uniformën nga institucioni juaj, por akoma nuk janë futur punë.

Ermonela Felaj – Jo në kohën që jeni ju drejtor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agim Ismaili – E kam të qartë, por nuk e mbarova fjalinë. Në rastin që po flasim, nuk ka person që u ka dalë urdhri për punë dhe nuk është pranuar në punë. Problemin e testimit të vitit 2018 e kam konstatuar jo vetëm për Shkodrën, por ka pasur një keqkuptim për rankimin që u është bërë personave. Ka një komision që i ka rankuar dhe ka nxjerrë urdhrat, por atyre nuk u ka dalë urdhri. Në shumë raste kur janë ankuar, i kemi thirrur në konkursin e radhës në vitin 2019 dhe ata që kanë dalë fitues sot janë në punë. Ata që kanë marrë uniformën, të konkurrojnë përsëri në konkursin e radhës, nëse fitojnë uniformën, le të vijnë në punë, por, nëse nuk e fitojnë, të dorëzojnë uniformën dhe jemi në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, është tejkaluar si problem, për shkak se kemi bërë rekrutime të reja në vitin 2019. Po e përsëris edhe një herë, që nuk kemi asnjë kontestim të vetëm që i është bërë hile gjatë këtij procesi. Sot ose nesër do të hapim testimin e radhës për vakancat e krijuara, ata që kanë uniformat, nëse fitojnë, të vijnë në punë.

Ermonela Felaj – Megjithatë, mund ta zgjidhni problemin, ju mund t’i çoni zotit Ismaili një listë të këtyre personave dhe të dhënat e tyre...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Doni t’i fusni në konkurs për herë të dytë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drejtori thotë se kanë ndodhur disa ngatërresa...

Agim Ismaili – *(Flet pa mikrofon)* ... që përbën indice për mua për t’u thënë se kush i ka shpërndarë rrobat, sepse rrobat nuk i merr kush pa dalë urdhri i emërimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ky është një problem që drejtori e ka gjetur dhe shpresojmë që të zgjidhet, sepse ka mundësi të zgjidhet.

Fjalën e ka zoti Vorpsi dhe pastaj zonja Dhima.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti drejtor, në radhë të parë dua të vlerësoj performancën tuaj në krye të këtij institucioni, por edhe për paraqitjen e të gjithë situatës së burgjeve në këtë takim përballë Komisionit të Sigurisë.

Unë kam dy pyetje. E para, a keni ju një studim dhe sa është numri i personave që i rikthehen botës së krimit si përsëritës?

E dyta, si është bashkëpunimi me pushtetin lokal, gjithmonë duke përfshirë rehabilitimin e të gjithë personave që dalin nga burgu, pra për fillimin e një pune?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Vorpsi!

Po, zoti Ismaili.

Agim Ismaili – Ju falënderoj për pyetjen!

Pasja e rekordeve pozitive në këto dy komponente që përmendi zoti Vopsi, janë tregues i realizimit të misionit të duhur të burgjeve me ato që janë kryesore: rehabilitimi dhe riintegrimi.

Nuk ka ndonjë protokoll të mirëfilltë masash si institucion dhe duhet që ata njerëz të përgatiten për liri. Ndër këto është hallka mes burgut dhe pushtetit vendor.

Në fakt, tashmë me shërbimin e provës, ku shumë nga ata kalojnë atë periudhë është bërë një hap shumë i madh përpara në qendrat e përgatitjes për liri dhe ka një zgjerim të bashkëpunimit me shërbimin të provës dhe bashkive. Është një përvojë, por dhe një standard shumë efikas, por duhet t'i bashkërenditet dhe pjesa tjetër e zinxhirit që jemi ne, që nuk është në ato nivele që do të dëshironim. E themi si fjalë retorike, për të qenë në rregull, por realisht kështu është e vërteta. Për bashkërendimin e institucionit për qasjen ndaj të burgosurve, po jap një shembull, që është realitet dhe konkret për çështjen e ekstremizmit, në kuadër edhe të Qendrës Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm janë përfshirë të gjitha këto, pushteti vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, shkollat e të tjera.

Recidivizmin e kemi në axhendën e punëve për të vënë kontakte dhe rekorde bashkëpunimi me pushtetin vendor për t'i njohur ata persona, për t'i përgatitur për liri, për të bërë maksimumin për t'i integruar. Kjo është përgjigjja që kam.

Ermonela Felaj - Recidivistët e keni pjesë të statistikës suaj? Sa recidiviste ka brenda? Në 300 e ca të dënuar që keni, sa prej tyre janë recidivistë?

Agim Ismaili – Patjetër, por nuk e kam këtë shifër këtu. Ligji thotë që për secilin sipas veçantive duhet të ketë program të posaçëm rehabilitimi dhe riintegrimi. Modulin e këtij programi e kemi të posaçëm me ato kapacitete, mundësi që kemi, të cilat janë në rritje për recidivistët.

Ermonela Felaj - Nëse do ta gjeni, na e thoni numrin më vonë.

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti drejtor!

Tashmë është kthyer në traditë që në Komisionin për Sigurinë Kombëtare institucione të ndryshme raportojnë për punën, problemet dhe për problematikat e tyre. Për këtë gjej rastin të falënderoj kryetaren e Komisionit, zonjën Felaj, e cila e ka bërë risi në këtë komision.

Kam dy pyetje. Ka qenë pothuajse e njëjta periudhë e vitit të kaluar, kur ish -drejtuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka bërë prezentë disa probleme dhe problematika.

Dua një informacion nga ana juaj, në buxhetin e vitit 2019, a është siguruar ndonjë autoburg për institucionet e burgjeve në mbarë vendin? Në kushtet kur ne jemi duke hartuar buxhetin e vitit 2020, a keni parashikuar dhe a i jeni drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me kërkesat specifike për të siguruar bazën e nevojshme materiale për të gjitha drejtoritë e burgjeve?

Përsëri në takimin që kemi bërë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është paraqitur si shqetësim pagesa e mjekëve dhe e farmacistëve, e cila është e ulët krahasuar me nivelin e pagave që marrin mjekët dhe farmacistët në sistemin e zakonshëm shëndetësor. Nuk e di, a e keni adresuar për zgjidhje ose a është zgjidhur ky problem? Pasi ata punojnë në kushte shumë të vështira. Në burgun e Fierit kam parë se numri i të burgosurve është shumë i konsiderueshëm dhe përgjegjësia e personelit shëndetësor është maksimale.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Dhima!

Po, zoti Ismaili.

Agim Ismaili – Është parashikuar në buxhetin e vitit 2019 një fond prej 36 milionë lekësh për autoburgjet. Siç jemi informuar nga agjencia e blerjeve, procesi po vazhdon, do të realizohet ky investim, dhe shkon drejtpërdrejt në interes të asaj që thatë edhe ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

3 autoburgje, 3 ambulanca.

Është zgjidhur kjo pjesë. Siç e përmenda dhe më lart në lidhje me logjistikën ka pasur investime shumë serioze edhe vjet, edhe sivjet dhe do të ketë edhe vitin tjetër në lidhje me sigurinë për: skanerë, metal detektor, në autoburgje, përveç donacioneve. Pra, është një çështje e adresuar.

Është e vërtetë puna e pagesës së mjekëve dhe të farmacistëve, që patjetër është përmendur edhe nga drejtorët e mëparshëm. Unë kam gjetur një situatë tepër kritike në kuptimin që ishte një shqetësim i përditshëm dhe ishte ndër punët e para që e kam patur në fokus, por edhe porosi nga ministrat. Kemi ecur në 2 drejtime për pagat e tyre. E para, në drejtim të arsyetimit të projektbuxhetit për periudhën në vijim. Jo thjesht na duhen disa para për të rritur pagat e disa personave, por janë kërkesa që i kanë të gjithë, janë të merituar, por në fund të fundit kaq është buxheti. Pra, kemi mirëarsyetuar këto kërkesa dhe kjo gjë ka kaluar, do të ketë rritje. Ka dhe një përpjekje për disa masa specifike, një rregullim i posaçëm, një lloj tjetër mekanizmi financiar, për shkak se duhet patjetër që të rriten pagat për ta bërë atraktive edhe financiarisht punën në burg, sepse është një regjim realisht i vështirë për mjekët dhe ne e kemi adresuar si çështje.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ne ju nxisim, se meqenëse do të jemi para buxhetit, do të kemi rast që të riflasim, por duke qenë edhe ministrja e Drejtësisë prezente në këtë seancë, ju t'i adresoni të dyja këto çështje: atë të pagesës së mjekëve dhe të farmacistëve nëpër burgje, sepse duket që ka një mosdisponueshmëri nga ana e mjekëve për të shkuar dhe për të ushtruar këtë funksion pranë burgjeve.

Nga ana tjetër ju e thatë që në ligjin e ri “Për Policinë e Burgjeve” kemi parashikuar dhe mendoj se e zgjidhim çështjen e vjetërsisë, por ajo duhet të merret patjetër parasysh edhe nga Ministria e Financës, se gjithmonë është ajo që e thotë fjalën e fundit nëse mund ta përballojë ose jo. Ne ju inkurajomë që ta bëni këtë gjë. Ne jemi treguar të kujdesshëm që për problematika të tilla t'u shkruajmë institucioneve përkatëse që të jenë të parapërgatitura në momentin kur hartojmë buxhetin.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zoti drejtor për prezantimin e detajuar!

Mendoj se është shumë e nevojshme që si deputetë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare të kemi informacione të tilla në mënyrë të herëpashershme.

Pa dyshim do të shtoja edhe atë që tha zonja Dhima, se ridimensionimi i punës së komisionit me vizita nëpër institucione, na ka ndihmuar edhe ne për të kuptuar më tepër të gjitha problematikat dhe për të bërë më mirë funksionimin e punës si ligjvënës.

Jam e interesuar për një informacion më tepër në lidhje me burgun e grave. Ne kemi shkuar edhe si gra deputete për ta vizituar atë burg, gratë dhe vajzat që janë aty në ditë të veçanta, edhe për të qenë pranë tyre. Duke qenë se kemi vizituar edhe burgje të tjera, shikoj se ka një diferencë të madhe. Mendoj se duhet të jetë në prioritetin tuaj rikonstruksioni i burgut të grave. Pyetja ime është në lidhje me këtë gjë: a keni ndonjë plan konkret për nevojën, domosdoshmërinë për ta ridimensionuar dhe për ta rikonstruktuar këtë burg?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea për pyetjen në lidhje me burgun e grave!

Është e vërtetë që ne kemi qenë disa herë. Pjesa që është mundësuar gjithmonë për gratë e dënuara është ajo që ka të bëjë me amnistinë, sepse kanë qenë gjithmonë subjekte përfituese për shkak të gjinisë. Ne kemi një të dhënë: janë 93 gra aktualisht në burg, nga të cilat janë 62 të dënuara dhe 31 të paraburgosura. Nuk e di sesi qëndron kjo shifër tani, por besoj të jetë aty-aty. Gjendja e burgut të grave është e tillë që e gjithë situata mbahet nga ato vetë, se sa nga ndërhyrjet që ka bërë shteti. Ato kujdesen që në atë pjesë ku duhet të vuajnë dënimin ta mirëmbajnë atë ambient, por duket qartë që ka munguar dora e shtetit.

Agim Ismaili – Për kategorinë e të burgosurve-gra duhet se ka një sensibilitet shumë të madh nga shoqëria, por edhe nga Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve në aspektin e integritetit, rehabilitimit dhe përfshirjes së tyre në çdo lloj aktiviteti. U kemi qëndruar shumë afër në këtë aspekt. Gratë nga natyra mirëmbajnë burgun në aspektin e pastërtisë, por e kanë mbajtur burgun me fondet buxhetore të limituara. Kjo është një situatë prej shumë vitesh, por megjithatë me fonde buxhetore të limituara që kanë qenë në dispozicion për ta shpëtuar së pari nga degradimi i mëtejshëm. Ne jemi përpjekur të rikuperojmë diçka pak nga pak. Kemi në plan disa fonde në dispozicion për punime të kësaj natyre, por për një ndryshim radikal, për të bërë një burg grash, nuk e kemi në plan dhe as mundësi, por e kemi si një shqetësim real dhe të drejtë.

Ermonela Felaj – Zonja Gjebrea është kryetare e Aleancës së Grave Deputete, kështu që pyetjet i ka me fokus gratë.

Elona Gjebrea - Ne vërtet duhet të përpiqemi më tepër për sa i përket asaj se çfarë mund të kontribuojmë që ky burg të ketë një pamje tjetër. Ne kemi një sensibilitet për çështjen e grave, sikurse e tha dhe kryetarja. Mendoj se mund të ndihmojmë të gjithë së bashku. Ka shumë

organizata ndërkombëtare që do të dëshironin ndoshta në formën e një dialogu që mund të bëhet me një projekt konkret për të mbështetur këtë gjë, e them si hipotezë: Komisioni European e të tjerë. Puna është se duhet të vendoset në prioritetin tuaj dhe jo çdo gjë bëhet me fondet e shtetit. Ju po bëni maksimalen me atë buxhet që keni, por duhet të gjenden edhe forma të tjera alternative për këtë pikë. Ne jemi të gatshëm të ndihmojmë me ide për ta zgjidhur këtë problem.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Gjebrea!

Një gjë tjetër me interes, meqenëse po flasim për aspektin gjinor, do të ishte të dimë, nëse ka gra drejtuese në sistemin e burgjeve?

Agim Ismaili - Po, ka. Kemi 3 gra drejtuese burgjesh, nga 24. Në hierarkinë e Policisë së Burgjeve kemi në funksione të larta një grua dhe kemi shumë gra police.

Ermonela Felaj - Kjo është gjë e mirë.

Më duhet të bëj disa pyetje për ta mbyllur këtë cikël të dëgjësës.

Ju falënderoj për të gjithë gatishmërinë tuaj!

Juve thatë se keni bërë një përllogaritje të atyre personave, keni krijuar një ide se sa duhet të jetë numri i personave që do të kalojnë në regjimin e posaçëm të burgjeve “41-bis”, a mund të kemi një shifër, ndër 3001 të dënuar, sa është predispozita më e lartë për të shkuar në këtë regjim?

Agim Ismaili - Ne nuk kemi bërë përllogaritje, se sa mund të kalojnë në sistemin “41-bis”, absolutisht nuk e kemi mundësinë, edhe ligji nuk e ka mundësinë. Ky është një proces. Ne kemi nxjerrë në mënyrë ekzakte të burgosurit që janë në sistem, të cilët potencialisht mund t'i nënshtrohen “41-bis”-it në aspektin e verifikimit mekanik të procesit. Ligji për mbikëqyrjen e posaçme përfshin vetëm ata të burgosur që janë dënuar për një kategori të përcaktuar veprash penale në kuadër të organizatës kriminale. Ne kemi hapur librat e dokumentacionit...

Ermonela Felaj - Pak a shumë sa shkon ky numër? Normalisht, vendimi do të merret nga ministri i Drejtësisë dhe ka një procedurë tjetër.

Agim Ismaili - ...se kush janë këta të burgosur. Janë 270 të burgosur që kanë kryer vepra penale në kuadër të organizatës kriminale, që nëse përmbushin kriteret sipas ligjit, shkojnë në “41-bis”.

Ermonela Felaj - Kjo është e qartë dhe nuk është marrë vendimi për askënd.

Agim Ismaili – Kam përshtypjen, meqenëse është dhe media mund të krijohet kakofoni. Nuk ka asnjë emër...

Ermonela Felaj- Për të cilin është marrë një vendim.

Agim Ismaili - Procesi është i tillë: është prokurori special, i cili bën propozimin e arsyetuar për ministrin e Drejtësisë për kalimin e njërit apo të tjetrit në “41-bis”. Kriter për të kaluar në “41-bis”, është kur ka të dhëna se ata koordinojnë, ndërveprojnë me organizatat kriminale apo me organizatat e tjera kriminale brenda dhe jashtë burgut. Këto janë kriteret për të cilat një person shkon në “41-bis”. Më pas ministria e Drejtësisë ka mekanizma të tjera verifikues, e thotë ligji, në Ministrinë e Brendshme, plus edhe të dhëna nga Shërbimi Informativ, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe struktura të tjera të kësaj natyre. Ky është procesi. Unë nuk di të ketë propozim konkret nga prokuroria për kalimin e njërit apo të tjetrit në “41-bis”. Po e përsëris, ne i kemi evidentuar nga librat të burgosurit, të paraburgosurit, të cilët kanë kryer vepra penale apo akuzohen për vepra penale, që futen në fushën e veprimtarisë “41-bis”.

Ermonela Felaj - Kemi parë që ju i keni përgatitur ambientet, i keni marrë masat, që në çdo rast të mos vonohet zbatimi i ligjit në këtë pikë, për vendosjen e regjimit të posaçëm, ndërkohë që prokurori i Prokurorisë së Posaçme apo po marrim Krimet e Rënda, sepse ende nuk është krijuar Prokuroria e Posaçme, nuk e inicion totalisht vetëm këtë proces, pasi i duhet të ketë informacione nga disa drejtorë të tjerë: nga drejtori i Policisë së Shtetit, nga drejtori i SHISH-it. Në dijeninë tuaj, mund edhe të mos e dini, a ka nisur ndonjë përgatitje e tillë nga ana e atyre strukturave nga poshtë që shkojnë te prokurori i Krimeve të Rënda dhe pastaj te ministri i Drejtësisë apo nuk ka informacione nga brenda sistemit të burgjeve që të fillojë të ndërtohet kjo punë?

Agim Ismaili – Prokuroria nuk është inaktive...

Ermonela Felaj- Jo është aktive, patjetër, por informacionet i merr nga brenda

Agim Ismaili – Prokuroria patjetër që merr informacione nga strukturat, por ajo është vetë institucion që heton dhe nga statistikat thuhet se gjysmat që janë në burgje i ka në hetim. Nga hetimi presupozohet që prokuroria të jetë aktori, prandaj ligji e ka përcaktuar si aktorin kryesor në këtë aspekt, që në kuadër të hetimit, të veprimeve proaktive, të marrë informacione, të dhëna, që x-i, i cili është brenda në burg, drejton, koordinon dhe vepron e të tjera me bandën jashtë e të tjera. Për të paraburgosurit që janë në hetim, automatikisht logjika ta kërkon që prokuroria është kryesorja në këtë proces, sepse janë në hetim.

Ermonela Felaj - Zoti drejtor, më fal!

Nuk e kam debatin me ju, por në përgjithësi. Duhet të jemi pak racionalë. Prokuroria e Posaçme ende nuk është krijuar. Do të marrë x kohë që ne nuk e dimë, por shpresojmë se do të jetë e shpejtë, pasi një sërë nga ata kanë kandidatë. Të paktën 8 kandidatë kanë kaluar vetingun dhe duhen 2 apo 3, nuk e di nëse jam e saktë që të plotësohet numri 10 për ta krijuar. Do njëfarë kohe deri në atë moment. Ju, si mendoni, duhet ta ndërtojmë këtë punë, që të mos e lemë vetëm në dorë të një aktori se kur t'i lidhë të dhënat, kur të informohet, pasi e keni parasysh se prokuroria tani është e decentralizuar dhe kontrollin për çdo dosje të veçantë e ka prokurori i çështjes dhe nuk e ka drejtuesi? Ju jeni brenda sistemit të burgjeve, si mundet ta ndërtojmë më mirë këtë punë? Si mendoni ju, që të mos kemi vonesa? Ju jeni bërë gati, ambientet i keni gati, problematika ekziston. Ju thatë se keni 32 vetë që i keni disiplinuar duke shfrytëzuar rregulloren e vjetër. Shumë mirë keni bërë! Pra, ka një gjë të tillë. Tani këtë punë si e inicioni më shpejt, si e nxisni? Gjithmonë, dua këndvështrimin tuaj praktik, sepse ligji e thotë.

Agim Ismaili - E thashë dhe po e përsëris qartë në drejtori në e Përgjithshme të Burgjeve kur ky ligj hyri në fuqi, gjatë kësaj periudhe, ne kemi bërë një proces mekanik, kemi evidentuar se cilët janë ata, që potencialisht nëse koordinojnë, veprojnë dhe ndërveprojnë e të tjera me organizatën, do të shkojnë në “41-bis”.

E dyta, kemi nxjerrë dhe kemi informuar prokurorinë për këtë, çdo të dhënë që kemi për ta, që mund të shërbejë si indicie për t'u verifikuar, a duhet të shkojë në “41-bis”. Çfarë janë këto të dhëna? Kemi verifikuar se cilin takojnë ata? I kemi në regjistra, i kemi shënuar. I kemi thënë prokurorit. Ne kemi kapur një rast në Fier, kapëm një person në kërkim, që takoi një të burgosur. Pra, cilin takojnë ata? Kush vjen për t'i takuar këta njerëz nga bota jashtë? Mund të vijë një pjesëtar i organizatës kriminale, që mund ta ketë kryer dënimin ose arsye nga më të ndryshmet dhe ne kemi informuar prokurorin. Kemi nxjerrë të gjitha rastet kur këta persona janë kapur me sende të ndaluara, pasi nëse është kapur me celular është një indikacion i fortë që ai burgosur po ndërvepron me dikë. Jo vetëm kaq, por kemi nxjerrë të dhëna edhe kur është kapur dikush në dhomë me celular, duke menduar ose e jep celularin, ose celulari është i tij, por ka vendosur emrin e atij tjetrit. Pra, çdo e dhënë dhe indicie që mund të shërbejë se ai ndërvepron me organizatën me jashtë, që ne e kemi disponibël e kemi shënuar. Kemi nxjerrë akte regullative, urdhëresa të brendshme për mënyrën e monitorimit ndaj tyre, në kuptimin jo që të cenojmë fshehtësinë, apo gjëra të garantuara me ligj, por për të evidentuar në mënyrë të posaçme çdo gjë që ndodh dhe çdo gjë që ata bëjnë. Ne e kemi bërë pjesën tonë në mënyrë proaktive pa asnjë

diskutim, përveç kësaj kemi ngritur edhe zërin, duke thënë që depozita e madhe, ku mund të merret informacion se kush ndërvepron me jashtë, është hetimi i rasteve për sendet e ndaluara në burg, si celularët, sepse aty ke celularë në dorë, është mundësia që, me mjete teknologjike, të bëhen ekzaminimet e duhura se me kë ka folur, kur ka folur, çfarë lidhjesh ka, çfarë ndërveprimi, çfarë mesazhi ka dërguar etj, pra, nuk keni thënë kurrësesi që e ka në dorë prokuroria, edhe pse në fakt ajo e ka për ta çuar çështjen në Ministrinë e Drejtësisë, por kemi qenë shumë proaktivë, kemi marrë pjesë edhe në takime dhe vazhdojmë të jemi gatshëm, për të bërë çdo gjë që duhet në funksion të mbarëvajtjes së këtij procesi.

Ermonela Felaj – Besoj do të kemi rast me deputetët e këtij komisioni të vijmë e t'i shohim paraprakisht ambientet pa filluar ende zbatimin e regjimit të posaçëm. Kanë ndodhur disa lëvizje së fundmi në burgje, ose të paktën është folur nga media. Kjo paqëndrueshmëria në detyrë sa ju ka shqetësuar? Si mendoni ta rekuperoni?

Agim Ismaili – Po, kanë ndodhur disa lëvizje, por nuk mund të them që kjo konfirmon paqëndrueshmërinë në detyrë, jo të këtyre që lëvizin, se ajo është dukshme, por në përgjithësi të organizatës, për shkak se pjesa natyrore e një organizate janë edhe nivelet e dyta, që mbajnë peshën dhe kanë edhe kohezionin e organizatës. Nga këto lëvizje brenda organizatës ka pasur njerëz që janë rritur në detyrë, duke identifikuar gjithçka të shëndetshme për ta ngritur atë, por ndryshimi ka qenë i nevojshëm, për shkak se dikush nuk e arriti dot atë që duhet të bëjë në sistemin e burgjeve në aspektin e mentalitetit për qëndrimin gjithnjë kundër ndaj qëndrimit preferencial për të burgosur të veçantë e për disa problematika konkrete, që ngelen vetvetiu rrugës. Procesi i ri, në sytë e mi, si pjesë e tij, ishte brilant, supertransparent dhe gjithëpërfshirës. Unë kam bërë propozimet për ndryshime te ministrja. Ne kemi shumë të rinj që u zgjodhën, të cilët kanë mentalitet të ri, me hop dhe cilësi të re.

Ermonela Felaj – Është e qartë se duhet ta rrisim kontrollin, që të evitonim lëvizjet në sistem dhe veçanërisht në drejtim të integritetit të njerëzve. Nuk e di së çfarë mekanizmi do të vendosni, të them të drejtën nuk më duket zgjidhje vetingu, sepse abuzohet shumë më këtë fjalë. Të mos mendojmë se procesi i vetingut është aq i thjeshtë, pasi merr kohë dhe ne peshojmë konkretisht me vetingun e policisë, kështu që duhet të jemi pak më të shkathët, të operojmë më mirë me ato të dhëna që kemi nga sistemi i prokurorisë, nga gjykatat, nga opinionin dhe nga inspektorë të shumtë të policisë në zona, që kanë informacione për njerëzit. Prandaj t'i shfrytëzojmë të gjitha këto burime, sepse vetingu vetëm emrin ka të ri, se edhe më herët nuk është

se organet nuk kanë pasur mundësi të njiheshin me rrethin shoqëror dhe me sjelljen e një personi, duke u garantuar, ndoshta jo 100%, por 90% për integritetin e një personi. Unë do të thosha që do të ishte më mirë të fokusoheshim këtu. Ju thatë që janë bërë disa konkurse, ka filluar një bashkëpunim tjetër me Akademinë e Rendit, gjërat janë modernizuar, por kemi pasur probleme edhe gjatë kësaj kohe. Nuk dua të kujtoj rastin e Lulzim Sakës, i cili doli para kohe dhe u bënë problem drejtuesit e burgjeve, por është një gjë që më bën të pyes se sa të sigurt jemi me strukturën e juristëve në burgje, që i bëjnë mirë llogaritë për njerëzit që duhet të lirohen nga burgjet? Këtë e them sepse është liruar një i burgosur me rrezikshmëri të lartë.

Agim Ismaili – Në lidhje me vetingun unë e përmenda qëparë në fjalën time që kemi bërë verifikime për përshtatshmërinë, nuk përmenda fjalën veting, për policët dhe nuk është marrë asnjë punonjës policie pa marrë konfirmim për përshtatshmërinë me të dhënat, që janë në dispozicion pa e bllokuar procesin. E njëjta gjë është bërë mbi bazën e një kujdesi krejt specifik dhe të veçantë për ministren për çështjen e drejtuesve të rrinë në burgje. Ato urdhra, ato procedura për verifikimin e përshtatshmërisë dhe të aftësive komunikuese me shkrim e me gojë janë publike, i kemi bërë dhe vazhdojmë t'i bëjmë. Me gjasë do të ulen këto raste, ndoshta nuk do të përjashtohen kurrë, por është luftë e përjetshme mes dy botëve.

Në lidhje me rastin e Lushnjes, duhet ta themi që ai rast nuk u denoncua nga dikush, por vetë sistemi i burgjeve e konstatojë atë gabim, e denoncuam në organet e prokurorisë për shpërdorim detyre të kartelistit dhe drejtorit të burgut. Është një verifikimi i kryer mbi bazën e urdhrit të ministres në të gjitha burgjet për të parë se si është bërë ky proces i përlllogaritjes së liritimit të të burgosurve.

Deri tani rezultatet, pasi janë kontrolluar shumica e IJPP-ve tregojnë se marzhi i gabimit nuk përbën shqetësim, mund të kemi gabime, raporti përfundimtar nuk ka dalë, por nuk është situatë aq problematike sa mund të thuhet, megjithatë çështjet e ekzekutimit të vendimeve (ne jemi një pjesë e procesit, pasi prokurori përmbaron në bazë të urdhrave) ia kemi paraqitur të gjitha prokurorive si shqetësim, flas për rastet kur janë të pasakta. Gjithmonë, kur ndodh diçka në burgje, bëhet bujë, kurse kur bëhen gabime në struktura të tjera, si gjykata, prokuroria apo Policia Gjyqësore nuk përmenden. Megjithatë ne duhet të jemi të pastër dhe në rregull me veten tonë dhe po përpiqemi ta bëjmë këtë.

MBYLLET MBLEDHJA